



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË NXITJES SË BIZNESIT DHE
ÇËSHITJEVE TË TREGËTISË
DREJTORIA E POLITIKAVE TË TREGUT TË BRENDSHËM

Nr. 2009/3 prot.

Tiranë, më 20.07.2026

URDHËR

Nr. 33, Datë 20.07.2026

“PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MIRATIMIN E TIPIT TË
INSTRUMENTEVE MATËSE LIGJËRISHT TË KONTROLLUARA”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 21, të ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Rregullores për miratimin e tipit të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri që është pjesë përbërëse e tij.
2. Urdhri nr. 196, Datë 09.03.2009 “Për miratimin e tipit të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluar”, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Delina Ibrahimaj



RREGULLORE

“PËR PROCEDURËN E MIRATIMIT TË TIPIT TË INSTRUMENTEVE MATËSE LIGJËRISHT TË KONTROLLUARA”

MASAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Kjo Rregullore përshkruan procedurën për miratimin e tipit të instrumenteve matëse, dokumentacionin teknik që duhet t'i bashkëngjitet aplikimit për miratimin e tipit të instrumentit matës, numrin e instrumenteve matës të të njëjtit lloj që duhet të dorëzohen për testim, përmbajtjen e raportit për ekzaminimin e tipit të instrumentit matës, ruajtjen e dokumentacionit teknik dhe instrumentit matës.
2. Kjo Rregullore, gjithashtu, përshkruan procedurën për pranimin e dokumenteve për miratimin e tipit të instrumenteve matëse, të lëshuara në përputhje me përcaktimet e Nenit 30 të Ligjit nr. 126/2020 “Për metrologjinë”.

Neni 2

1. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, jep miratimin e tipit dhe lëshon certifikatën e miratimit të tipit për secilin instrument që plotëson kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe Rregullores së Këshillit të Ministrave, për kërkesat teknike dhe metrologjike të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, sipas përcaktimeve të pikës 5 të Nenit 17 të Ligjit nr. 126/2020.
2. Kjo Rregullore nuk zbatohet për instrumentet matëse, vlerësimi i konformitetit i të cilëve rregullohen me Vendimin Nr. 770, datë 2.11.2016 “Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet matëse”, për disa ndryshime në Vendimin nr. 1351, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara” dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 631 datë 25.9.2019 “Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet e peshimit jo-automatik” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”.

Neni 3

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, krijon dhe mirëmban regjistrin e të gjithë tipeve të miratuar dhe të njohur dhe i publikon ato në Buletinin Zyrtar Metrologjik dhe informon subjektet/palët e interesuara, me kërkesë të tyre.

KËRKESA PËR MIRATIM TIPI TË INSTRUMENTEVE MATËSE

Neni 4

1. Kërkesa për miratimin e tipit të instrumentit matës paraqitet nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, këtej e tutje “aplikanti”, me seli në Republikën e Shqipërisë, sipas Aneksit 1 të kësaj Rregulloreje, në formë të printuar.
2. Kërkesa për miratim tipi, korrespondenca dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kërkesës duhet të jenë në gjuhën shqipe.
3. Kërkesa për miratimin e tipit të instrumentit matës duhet të përmbajë:
 - a) Emrin dhe adresën e prodhuesit, ose të përfaqësuesit të tij/saj të autorizuar;

- b) Llojin, kategorinë e instrumentit / sistemit matës;
 - c) Karakteristikat e matjes dhe qëllimin e përdorimit të instrumentit matës;
 - d) Një listë të elementeve dhe komponentëve teknikë thelbësorë që përbëjnë llojin e instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar për të cilin kërkohet miratimi i tipit.
4. Kërkesa duhet të shoqërohet nga dokumentet e nevojshme për vlerësimin e instrumentit matës, në dy kopje origjinale ose të noterizuara, që përfshijnë:
- 4.1 Një përshkrim të veçantë për:
 - i. Ndërtimin dhe funksionimin e instrumentit;
 - ii. Rregullat mbrojtëse që sigurojnë një punë korrekte;
 - iii. Pajisjet për rregullim dhe axhustim (përshtatje);
 - iv. Vendet e synuara për vendosjen e:
 - Shenjës së miratimit/verifikimit
 - Vulat (nëse aplikohen)
 - 4.2 Projektin konceptual, vizatimet e prodhimit dhe planet e elementëve përbërës, nën njësitë, qarqet etj.
 - 4.3 Sipas rastit/kur është e zbatueshme, një përshkrim të pajisjeve elektronike me vizatime, diagrama, duke shpjeguar karakteristikat e tyre dhe funksionimin.
 - 4.4 Një vizatim skematik që ilustron parimet e funksionimit dhe kur është e domosdoshme dhe fotografi.
- a) Një mostër ose maket të instrumentit.
5. Për instrumentet matëse të pajisura me softuare, dokumentacioni teknik i referuar në pikën 4 të këtij Neni duhet të përmbajë gjithashtu:
- i. Përshkrimin e softuerit (performanca e harduerit dhe softuerit të instrumentit);
 - ii. Një përshkrim se si komunikojnë komponentët e instrumentit /sistemit matës;
 - iii. Të dhënat dhe udhëzimet për identifikimin e elementeve të programit/softuarit;
 - iv. Një deklaratë me shkrim nga prodhuesi i instrumentit (ose prodhuesi i softuerit) që softueri kryen vetëm funksionet e përshkruara sipas germës a);
 - v. Një përshkrim të procesit të programimit dhe testimit të softuerit;
 - vi. Rezultatet e testeve të kryera nga prodhuesi i instrumentit (ose prodhuesi i softuerit);
 - vii. Miratimin e tipit të softuerit, të lëshuar nga një institucion i huaj i autorizuar nga shteti për metrologjinë ligjore;
 - viii. Metodën e mbrojtjes së softuerit (mundësinë e vulosjes / plumbosjes, kur është e mundur).

EKZAMINIMI PËR MIRATIM TIPI TË INSTRUMENTEVE MATËSE

Neni 5.

1. Ekzaminimi për miratim tipi duhet të përfshijë:
- 1.1 Studimin e dokumenteve dhe një ekzaminim të karakteristikave të matjeve të tipit/modelit në laboratorët e Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë, në laboratorë të akredituar për testim që lidhen me kategorinë përkatëse të instrumenteve matëse ose në vendin e prodhimit, të shpërndarjes ose të instalimit.
 - 1.2 Nëse karakteristikat e matjeve të tipit/modelit njihen në detaje, bëhet vetëm një ekzaminim i dokumenteve të dorëzuara me kërkesën për miratim tipi.
2. Ekzaminimi i miratimit të tipit do të përfshijë të gjithë performancën e instrumentit matës në kushte normale të përdorimit. Në kushte të tilla, instrument duhet të ruajë karakteristikat e kërkuara të matjeve.

3. Natyra dhe fushëveprimi i ekzaminimit të përmendur në pikën 1 të këtij Neni përshkruhen në Rregulloren e Këshillit të Ministrave për kërkesat teknike dhe metrologjike të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, sipas përcaktimeve të pikës 5 të Nenit 17 të Ligjit nr. 126/2020.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë mund të kërkojë që aplikanti t'i vendosë në dispozicion, etalonet dhe mjetet e nevojshme në aspektin material dhe personel ndihmës për kryerjen e testeve të miratimit të tipit.

TESTIMI I TIPIT TË INSTRUMENTEVE MATËSE

Neni 6

1. Aplikanti duhet të dorëzojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë një numër të përshtatshëm të mostrave të tipit të instrumentit matës, shoqëruar nga dokumentacioni përkatës teknik.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë pasi verifikon plotësinë e aplikimit dhe dokumentacionit shoqëruar, vijon me kryerjen e testimeve.

2. Bazuar në rezultatet e testimeve, hartohet raporti i ekzaminimit të tipit.

3. Raporti i ekzaminimit të tipit përfshin, shqyrtimin e dokumentacionit teknik, testimin e karakteristikave metrologjike dhe vlerësimin e përshtatshmërisë së tij.

4. Karakteristikat metrologjike dhe përshtatshmëria testohen dhe vlerësohen kundrejt kërkesave përkatëse, të përcaktuara në Rregulloren e Këshillit të Ministrave për kërkesat teknike dhe metrologjike të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar.

5. Kur është e nevojshme, Aplikanti duhet të sigurojë kushte normale pune në vendin e instalimit të instrumentit matës që do t'i nënshtrohet testeve për miratim tipi dhe të vendosë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë mjetet dhe personelin e nevojshëm.

LËSHIMI I CERTIFIKATËS TË MIRATIMIT TË TIPIT DHE VLEFSHMËRIA E SAJ

Neni 7

1. Kur Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka përfunduar ekzaminimin e tipit të një instrumenti matës dhe ka nxjerrë një konkluzion pozitiv për përputhshmërinë e tij, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë lëshon certifikatën e miratimit të tipit sipas Aneksit 2 të përfshirë në këtë rregullore.

2. Certifikata e miratimit të tipit duhet të përfshijë:

- i. Emrin dhe adresën e aplikantit
- ii. Llojin/kategorinë e instrumentit
- iii. Tipin ose modelin e instrumentit
- iv. Emrin dhe adresën e prodhuesit
- v. Përcaktimin zyrtar të tipit
- vi. Periudhën e vlefshmërisë

3. Certifikata e miratimit të tipit duhet të shoqërohet me një aneks teknik që duhet të përfshijë:

- i. Kërkesat metrologjike të zbatueshme
- ii. Përshkrimin teknik të ndërtimit të instrumentit
- iii. Parimin e funksionimit të instrumentit

- iv. Diapazonet/kufijtë e matjes dhe kufijtë e gabimit
 - v. Kushtet ambientale referencë të funksionimit
 - vi. Vizatime, diagrame, listë të pjesëve dhe fotografi
 - vii. Etiketat, shenjat dhe vulat
 - viii. Metodën e vulosjes dhe periudhën e vlefshmërisë së vulës, kur është e mundur
- Për instrumentet e programuara, përveç kërkesave të mësipërme aneksi teknik duhet të përfshijë:
- ix. Përshkrimin e softuerit dhe identifikimin e parametrave të memories/procesorit
 - x. Metodën e mbrojtjes së softuerit
3. Miratimi i tipit i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është i vlefshëm për një periudhë 10 vjeçare. Me kërkesë të Aplikantit, DPM mund të zgjasë miratimin për 10 vjet të tjera, bazuar në dokumentacionin ekzistues dhe atë shtesë. Numri i instrumenteve matëse, që mund të prodhohen në përputhje me një tip të miratuar, është i pakufizuar.
 4. Miratimi i tipit, i dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, nuk mund të zgjatet pas datës së hyrjes në fuqi të ndonjë ndryshimi të Vendimit të Këshillit të Ministrave për kërkesat teknike dhe metrologjike të instrumenteve matëse, në rastet kur miratimi i tipit nuk mund të ishte dhënë në bazë të këtyre ndryshimeve.
 5. Kur vlefshmëria e miratimit të tipit nuk zgjatet, ky miratim do të vazhdojë të jetë i vlefshëm për instrumentet matës ligjërisht të kontrolluar që janë tashmë në shërbim / përdorim.

FIKSIMI I SHENJAVE TË MIRATIMIT TË TIPIT NË INSTRUMENTET MATËSE TË PRODHUARA NË PËRPUTHJE ME TIPIN E MIRATUAR

Neni 8

1. Shenja për miratimin e tipit përcaktohet sipas Aneksit 3 të përfshirë në këtë rregullore.
2. Shenja për përjashtimin nga miratimi i tipit përcaktohet sipas Aneksit 4, të përfshirë në këtë rregullore.
3. Shenja e miratimit të tipit me efekt të kufizuar jepet në Aneksin 5, të përfshirë në këtë rregullore.
4. Shenjat sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij Neni duhet të fiksohen në çdo instrument matës dhe/ose në certifikatën e miratimit të tipit.
5. Shenjat e përmendura në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij Neni, të fiksuara nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, në përputhje me masat e kësaj rregullore, duhet të jenë në një vend të dukshëm të instrumentit dhe të gjithë pajisjeve ndihmëse që i nënshtrohen verifikimit dhe duhet të jenë të lexueshme dhe të paheqshme. Në rast se kjo nuk mundësohet ose nuk garantohej për shkak të natyrës së instrumentit matës, ato vendosen në dokumentet shoqëruese dhe, nëse ka, në paketim.

MODIFIKIMET OSE SHITESAT NË TIPIN E MIRATUAR

Neni 9

1. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij janë të detyruar të informojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, rreth çdo modifikimi apo shtesë në tipin e miratuar.
2. Modifikimet ose shtesat e një tipi të miratuar duhet të marrin një miratim të ri të tipit nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, atëherë kur këto ndryshime ndikojnë ose mund të ndikojnë rezultatet e matjeve ose kushtet e përshkruara për përdorim të instrumenteve matëse.
3. Procedura për miratimin e modifikimeve ose shtesave të një tipi të miratuar është e njëjtë me procedurën e miratimit të tipit.

Neni 10

Kur miratimi i tipit nuk kërkohet për një kategori instrumentesh prodhuesi, me përgjegjësinë e tij, mund të vendosë në instrumentet e kësaj kategorie shenjën e veçantë të përshkruar në Aneksin 4, bashkëlidhur.

DEPOZITIMI I MOSTRËS SË INSTRUMENTIT

Neni 11

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë kërkon depozitimin e mostrës së instrumentit për të cilën është dhënë miratimi i tipit, dhe të ruhet deri në 5 vjet pasi miratimi ka hyrë në fuqi.
2. Në pamundësi të depozitimit të mostrës të instrumenteve matës, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë të kërkojë depozitimin e pjesëve të instrumentit, të maketit apo vizatimeve dhe kjo përshkruhet në aneksin teknik të certifikatës së miratimit të tipit.

REFUZIMI I MIRATIMIT TE TIPIT

Neni 13

Drejtori i Përgjithshëm i Metrologjisë nxjerr një vendim për refuzimin e miratimit të tipit të instrumentit matës, nëse tipi i testuar i këtij instrumenti nuk plotëson karakteristikat teknike dhe metrologjike të përshkruara në Rregulloren e Këshillit të Ministrave.

SHENJA E MIRATIMIT TË TIPIT QË PËRJASHTON VERIFIKIMIN FILLESTAR

Neni 14

Shenja e miratimit të tipit për instrumente që përjashtohen nga verifikimi fillestar, mbështetur në rregulloren për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentat matese ligjërish të kontrolluara" jepet në Aneksin 6.

REGJISTRIMI I TIPIT TË MIRATUAR

Neni 15

Të gjithë certifikatat e miratimit të tipit, njohjes së miratimit të tipit, si dhe ato të miratimit të tipit me kufizime, miratimit të tipit të modifikimeve apo shtesave, regjistrohen në regjistrin e të gjithë tipeve të instrumenteve matëse të miratuar apo të njohur.

Neni 16

1. Miratimi i tipit të instrumentit matës kryhet kundrejt tarifave të miratuara me Urdhër të Ministrit përgjegjës për ekonominë dhe financave.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nuk është përgjegjëse për dëmtimin ose shkatërrimin e mostrave gjatë testimit.

Aneksi 1

Formati i kërkesës për miratim tipi

APLIKIM PËR MIRATIM TIPI

DREJTORISË TË PËRGJITSHME TË METROLOGJISË

1. Të dhëna të përgjithshme të aplikantit

Emri i Subjektit prodhues apo përfaqësuesit të tij në Shqipëri

.....

Adresa e subjektit aplikues

.....

Nr. regjistrimit të subjektit

.....

Personi i kontaktit

Nr. Tel.....

Nr. Fax.....

E-mail.....

2. Tipi i instrumentit matës për vlerësim/miratim (*)

(*) Shënim; Pjesa nr.2 e kërkesës varion nga tipi dhe fusha e matjeve që i përket tipi i instrumentit matës i cili do të vlerësohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

CERTIFIKATË
E MIRATIMIT TË TIPIT TË INSTRUMENTIT MATËS (.....)

Numri i certifikatës

.....

Periudha e vlefshmërisë

.....

Prodhuesi

.....

Përshkrimi i instrumentit matës

.....

.....

.....

.....

.....

Lloji i miratimit të tipit

Shenja e miratimit të tipit.....

Data e lëshimit së certifikatës


DREJTORI PËRGJITHSHËM

Emri mbiemri, firma vula

Shenja e miratimit të tipit

Në pjesën e sipërme të S vendoset kodi i vendit dhe dy shifrat e fundit të vitit

Në pjesën e poshtme të S vendoset numri identifikues i miratimit të tipit (Nr. në regjistër)



Përmasat jepen në pjesë të njësisë e cila konsiderohet të jetë një nga përmasat e dhëna në serinë që vijon: 12,5 mm , 6.3 mm dhe 3.2 mm

Lartësia e shkronjës S merret	1 njësi
Gjerësia e shkronjës S	0.9
Trashësia e shkronjës S	0.08
Rrezja e madhe e jashtme	1
Rrezja e vogël e jashtme	0.248
Rrezet e brendshme merren sa rrezet e jashtme minus trashësinë e shkronjës	

Përmasat e shkronjave A dhe L merren :

• gjerësia	0.14
• lartësia	0.20
• trashësia	0.022

Përmasat e numrave merren:

• Gjerësia	0.10
• Lartësia	0.20
• Trashësia	0.020
• Rrezet e brendshme të vogla	0.03
• Rrezet e brendshme të mëdha	0.06
• Rrezet e jashtme merren sa rrezet e brendshme plus trashësinë e numrit	

Shenja e përjashtimit nga miratimi i tipit

Përmasat kryesore jepen në pjesë të njësisë e cila konsiderohet të jetë një nga përmasat e dhëna në serinë që vijon: 12,5 mm , 6.3 mm dhe 3.2 mm

- Lartësia e shenjës merret 1 njësi
- Gjerësia e shenjës merret 0.9
- Trashësia e vijave 0.14
- Trashësia e vijave të holla 0.08
- Rrezet e rrumbullakimit 0.14


Shenja e miratimit të tipit të kufizuar

LS AL 00

Përmasat e shkronjës L jepen në pjesë të njësisë e cila konsiderohet të jetë një nga përmasat e dhëna në serinë që vijon: 12,5 mm, 6.3 mm dhe 3.2 mm

Lartësia e shkronjës L merret	1 njësi
Gjerësia e shkronjës L	0.75

Shenja e miratimit të tipit që përjashton verifikimin fillestar



Përmasat e gjashtëkëndshjit merren

- Lartësia
- Trashësia e vijës së konturit

sa dyfishi i lartësisë së shkronjës S (aneksi 1.3)
0.08 njësi